

DANIELA–CARMEN STOICA

**PIKËSIMI I SHQIPES I VËSHTRUAR NË KRAHASIM
ME PIKËSIMIN E RUMANISHTES**

Në ligjërim përcaktohen marrëdhëniet logjike midis fjalëve, grupeve sintaksore dhe fjalive që formojnë njësi të ndara nga pikëpamja kuptimore. Për të shprehur këto marrëdhënie, ligjërimi njerëzor përdor, përveç proceseve gramatikore, pushimet, intonacionin ose ndërprerjen e komunikimit. Për këtë arsye shprehja me shkrim kërkon përdorimin e mjeteve grafike me ndihmën e të cilëve mund të evidentohen këto aspekte. Kjo shpjegon edhe krijimin e pikësimit – një sistem të shenjave konvencionale që kanë rolin e sinjalizimit me shkrim të pushimeve, të intonacionit, të ndërprerjes së ligjërimin.

Shenjat e pikësimit kanë një karakter konvencional dhe për këtë arsye nuk kërkohen nga natyra e përmbajtjes së shprehur. Me kalimin e kohës është përgjithësuar përdorimi i një shenje të caktuar të pikësimit për një situatë të veçantë. I fiksuar nga tradita, përdorimi i shenjave të pikësimit, me vlera të përcaktuara mirë, është bërë i domosdoshëm për të gjithë ata që duan të shprehin mendimet e tyre me shkrim. Nëse vihet re ende një mungesë së qëndrueshmërisë në përdorimin e shenjave të pikësimit (sidomos në përdorimin e presjes), kjo ndodh sepse ata që shkruajnë priren të mendojnë se marrëdhëniet sintaksore brenda fjalisë janë të vetëmjaftueshme për të shprehur marrëdhëniet midis njësisive kuptimore të ligjërimin. Gjithsesi, keqpërdorimi ose mospërdorimi i pikësimit çon në ngatërrim apo në shtrembërim të përmbajtjes së komunikimit.

Nevoja për të shprehur idetë me shkrim sa më qartë në mënyrë që ato të kuptohen më lehtë ka rritur interesin kohët e fundit për të vendosur rregulla në përdorimin e shenjave të pikësimit. Ndonjëherë pikësimi mund të përdoret për të nxjerrë në pah disa vlera stilistike. Në raste të tilla nuk mund të jepen rregulla, përdorimi i shenjave të pikësimit mbetet në dëshirë dhe shkrimtarit. Megjithatë, në këtë rast, shenjat e pikësimit stilistik nuk duhet të bien në kundërshtim me rregullat e bazuara në nevojat gramatikore.

Pikësimi në shqip dhe në rumanisht mbështetet në parimin sintaksor, i cili gërshetohet me parimin intonacionor. Për shembull, presja veçon grafikisht, një ose më shumë fjali brenda në një periudhë ose disa gjymtyrë brenda në një fjali. Presja tregon si shpërbëhet periudha apo fjalia në elementet e tyre përbërëse duke u bazuar në marrëdhëniet sintaksore ndërmjet tyre. Ky është funksioni gramatikor i presjes. Përsa i përket funksionit gramatikor, mund të jepen rregulla të sakta. Këto rregulla përcaktojnë kur duhet dhe kur nuk duhet përdorur presja dhe bazohen në lidhjen logjike midis ideve të shprehura njëra pas tjetrës në një fjali apo në një periudhë. Kjo është arsyeja pse nuk ka dallime thelbësore midis mënyrave të përdorimit të presjes në këto gjuhë. Gjithashtu, presja i përgjigjet një pushimi të shkurtër në ligjërimin e folur.

Në vazhdim do të analizojmë rastet identike apo të ngjashme kur përdoret presja në fjali, në shqip dhe në rumanisht, duke përdorur dy punime normative ende në fuqi të Akademive së Shkencave në Shqipëri dhe në Rumani: *Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe (2002)* dhe *Îndreptar ortografic, ortoepic și de punctuație (1995)*. Shembujt që kemi dhënë për të dyja gjuhët janë marrë pjesërisht nga këto dy punime, me referencat përkatëse në kllapa. Gjithashtu, duhet përmendur se një numër i madh shembujsh të cituar në rumanisht u përkasin shkrimtarëve të ndryshëm rumunë, të cilët janë tashme cituar në botimin e Akademisë Rumune (1995). Shembujt në rumanisht pa referenca i përkasin autores, shpesh duke mbartur të njëjtën strukturë dhe të njëjtin kuptim, për të nxjerrë në pah paralelizmin sintaksor në të dyja gjuhët. Gjithashtu, presjet brenda në shembujt në gjuhën rumune janë vendosur në kllapa, si në punimin e Akademisë.

1. Gjymtyrët homogjene pa lidhëza:

Së pari, në fjali, presja përdoret për të ndarë gjymtyrët homogjene, si për shembull kryefjalë, kundrinorë, përcaktorë etj, kur bashkohen pa lidhëza. Në rumanisht ky lloj raporti e ka emrin *juxtapunere* (fr. *juxtaposition*, lat. *juxta+ponere*)

- kryefjalë (rum. *subiecte*) me ose pa përcaktorë:

Çdo vijë e fytyrës, çdo lëvizje e dorës, çdo fjalë, çdo hap i Skënderbeut tregonte njeriun e veprave të mëdha. (2002: 35)

Chipul rumen[,] **gura** fragedă[,] **apele** ochilor și **focul** pârului spunea atâta frumusețe cutezătoare și iritantă. GALACTION, O. I 133–134 (1995: 64)

[Faqet e kuqe, buzët e ëmbla, sytë me lëng dhe ngjyra e zjarrtë të flokëve flisinin për një bukuri të guxhimshme dhe acaruese.]

Pikësimi i shqipes i vështruar në krahasim me pikësimin e rumanishtes

- kundrinorë (rum. *complemente directe/indirecte*) me ose pa përcaktorë:

Ai foli **për zakonet** arbëreshe, **për vallet**, **për këngët** popullore, **për luftën** e fisit të tij, **për qëndresën** mbinjerëzore të shqiptarëve. (2002: 35)

Danțul[,] **muzica** [,] **pădurea**[,]¹

Pe acestea le-ndrăgii. EMINESCU, O. I 102; (1995: 64)

[Me kërcimin, me muzikën, me pyllin,

Ai ra në dashuri.]

- përcaktorë (rum. *attribute*):

Mikpritja është një nga zakonet **më të lashta**, **më bujare**, **më njerëzore** të popullit tonë. (2002: 36)

Ascundeam în mine o viață **străină** celorlalți[,] **blândă** [,] **frumoasă** [,] **neînțeleasă**. DELAVRANCEA, H. T. 171. (1995: 64)

[Po mbaja të fshehtë brenda meje një jetë të panjohur për të tjerët, të butë, të bukur, të pakuptueshme.]

Duhet theksuar se përgjithësisht, në të dyja gjuhët kryefjala (me ose pa përcaktor) nuk ndahet me presje nga kallëzuesi:

Fusha, **këneta**, **qielli**, **kodrat** *kishin* marrë atë ditë një ngjyrë të zbërdhlytur.² (2002: 36)

Unii mai poznași îmi *zvârleau* câte o glumă. SADOVEANU, O. I 55;³ (1995: 64)

[Disa më të guximshëm bënin ndonjë shaka me mua.]

2. Gjymtyrët homogjene me lidhëza:

Gjithashtu nuk ndahen me presje gjymtyrët homogjene të fjalisë të bashkuara me lidhëzat *e/edhe*, *ose/olapo/a* në shqip, *și*, *sau*, në rumanisht. Ky lloj raporti në rumanisht quhet *jonçtiune* (<fr.*jonction*, lat. *jonctio*).

Oshëtima e lumit na shoqëron **në çdo bisedë e në çdo hap**. (2002: 37)

Maria și Ioana ... nu pãreau a fi prea optimiste. (1995: 66)

[Maria dhe Ioana ... nuk dukeshin shumë optimiste.]

Ai mbajti një fjalim para ushtrisë dhe tha se **liria ose vdekja** në skllavëri varej nga lufta që do të bënin kundër pushtuesve osmanë. (2002: 37)

Vrei **cartea sau caietul**? [Do librin apo fletoren?]

¹ Në rumanisht, kundrinorë të drejtë.

² Nënvizimi i autores.

³ Në këto dy shembuj kryefjalët janë shënuar me shkronja të errëta, ndërsa foljet me shkronja të pjerrëta.

Ndahen me presje gjymtyrët homogjene që bashkohen me lidhëzën kundërshtore *po (por)* në shqip, *dar*, në rumanisht (rum. *conjuncție adversativă*), ashtu edhe me lidhëzën këpujore *as*, në rumanisht *nici*:

E keqja njeriut nuk vjen nga urtësia, **por** nga mendjemadhësia. (2002: 37)

Nu ai greshit *din neștiință*, **ci** *din neatentie*.

[Nuk ke gabuar nga injoranca, por nga mungesa e vëmendjes.]

Ata nuk donin të vdisnin *shtrirë*, **as** *me gjunjë*. (2002: 37)

Nu accepta să vină *de bunăvoie* [,] **nici** *în genunchi*. (shembulli në rum. është përkthimi i shembullit në shqip)

Ndahen gjithashtu me presje gjymtyrët homogjene që bashkohen me lidhëza të përsëritura, apo me lidhëzat dyshe (rum. *conjuncții coordonatoare corelative*). Duam të theksojmë se për rastet e mëposhtme, shembulli në rumanisht është përkthimi i shembullit në shqip:

- *edhe/dhe...*, *edhe/dhe...* (rum.: *și...*, *și...*)
edhe qeros, edhe fodull
și râios, și cu coada sus
- *as...*, *as...* (rum.: *nici...*, *nici...*)
as andej, as këtej
nici încoace, nici încolo
- *hem...*, *hem ...* (rum.: *și...*, *și...*)
hem mirë, hem keq
și bine, și räu
- *si...*, *si...* (rum.: *cum...*, *așa și...*)
si njeri, si tjetri
cum unul, așa și celălalt
- *o...*, *o...* (rum.: *ori...*, *ori...*)
o sot, o kurrë
ori azi, ori niciodatë
- *ose...*, *ose...* (rum.: *sau...*, *sau ...*)
ose njeri, ose tjetri
sau unul, sau altul
- *qoftë...*, *qoftë...* (rum.: *fie...*, *fie.../sau...*, *sau...*)
qoftë sot, qoftë nesër
sau azi, sau mâine/fie azi, fie mâine
- *jo vetëm ...*, *por edhe ...* (rum.: *nu numai...*, *ci și ...*)

Vajzës i pëlqente të shkruante **jo vetëm** vjersha, **por edhe** tregime. (2002: 40)

Fetei îi plăcea să scrie **nu numai** versuri [,] **ci și** povești.

• *si ..., ashtu (edhe)...* (rum.: *atât..., cât și ...*)

I pa me sytë gjitha dhe qau me lot **si** vëllanë, **ashtu edhe** partizanin. (2002: 40)

[Le văzu pe toate și îi jeli cu lacrimi amare atât pe fratele lui, cât și pe partizan.]

• *sa..., aq edhe...* (rum.: *pe cât ..., pe atât ...*)

Ju bëni një punë **sa** të dobishme, **aq edhe** të vështire. (2002: 40)

Faceți o muncă **pe cât** de importantă, **pe atât** de dificilă

3. Format e pashtjelluara (rum. *modurile nepersonale*):

Format e pashtjelluara, si përcjellorja (rum. *gerunziu*), paskajorja (rum. *infinitiv*), pjesorja (rum. *participiu*) ose ndërtimet me to ndahen me presje kur ndodhen në fillim të fjalisë dhe vihen midis presjesh kur ndodhen në mes të fjalisë, sidomos para kallëzuesit. Më poshtë paraqiten shembuj ku përdorimi i shenjave të pikësimin për format e pashtjelluara në gjuhën shqipe paraqet ngjashmëri me gjuhën rumune:

- përcjellorja:

Duke qenë natyrë ëndërruese, ai *nisi* të përfytyronte se sido të dukej ky vend pas pak vjetësh. (2002: 43)

Fiind mediocru și ca învățătură, și ca inteligentă [,] *n-a putut* să izbutească. GALACTION, O. II 113. (1995: 65) [Duke qenë mediokër nga pikëpamja e dijeve, edhe nga ajo e inteligjencës, nuk pati sukses.]

- paskajorja:

Për të jetësuar këtë ngjarje, këtu *u ngrit* një lapidar. (2002: 43)

Pentru a-l convinge [,] a trebuit să lupte mult.[Për ta bindur, ajo luftoi shumë.]

Me të dalë⁴ në fund të fshatit, *çau* përmes pyllit me dushk e humbi nga sytë. (2002: 44)

- pjesorja:

Ajuns calfă la găitănărie, *vorbea* frumos și cu patimă în mijlocul tovarășilor săi. DELAVRANCEA, H. T. 16. (1995: 65) [Me t'u bërë mjeshër, ai filloi të fliste bukur dhe me pasion në mes të shokëve të tij.]

4 Kësaj forme i korrespondon në rumanisht një folje në formën e pjesores (Odată **ieșit** din sat[,])... ose në formën e përcjellores (**İeșind** din sat[,]) ...).

Gjithashtu, në të dyja gjuhët ndahet me presje forma e pashtjelluar të tipit *për të punuar* (të cilit në rumanisht i korrespondon një folje në formën e pashtjelluar të supinit) dhe të ndjekur nga një formë kohore e po asaj foljeje në mënyrën dëftore ose urdhërore.

Për të ngrenë, *nuk hëngri ...* (2002: 44)

De mâncat [,] *n-a mâncat*.

4. Gjymtyrët e veçura të fjalisë

Presja përdoret për të veçuar gjymtyrë të ndryshme të fjalisë që vendosen para rendit të tyre për shkak të ngjyimeve kuptimore që fitojnë ose për shkaqe stilistike.

- rrethorë (complemente circumstanțiale)

Dy ditë më vonë, në një kohë me erë dhe me shi, ne filluam përsëri marshimin. (rrethorë kohe)

Două zile mai târziu [,] pe o vreme cu vânt și ploaie, noi am reluat marșul. (rum. *complement circumstanțial de timp*; shembulli është përkthim i shembullit në shqip)

Këto gazeta, **nga përdorimi i tepërt**, u roniteshin njerëzve nëpër duart. (rrethorë shkak)

Acești copaci [,] **din cauza vântului puternic**[,] s-au rupt. (rum. *complement circumstanțial de cauză*)

[Këto pemë, për shkak të erës së fortë, u thyen.]

Ajri dridhej ngadalë, **si një rrjetë e hollë ...** (rrethorë mënyrë) (2002: 42)

Grigore [,] abia **stăpânindu-și** revolta[,] ndërprese vehement pe arendaș. REBREANU, R. I 40 (rum. *complement circumstanțial de mod*) (1995: 65)

[Grigori, duke kontrolluar me vështirësi revoltën e tij, ndërpreu me forcë qiramarrësin.]

5. Ndajshtimet shpjeguese (rum. *apozifiile explicative*):

Në të dyja gjuhët, ndajshtimet ndahen gjithmonë me presje, brenda në fjali:

Të tre djemtë, **Harilla, Llazi, Kozmai**, iu afruan zjarrit. (2002: 36)

Zeus [,] **feciorul lui Cronos**[,] fëcu semn din sprënceanë që primește. ODOBESCU, I 280 (1995: 65) [Zeusi, djali i Kronosit, sinjalizoi nga vetullat se ishte dakord.]

6. Fjalët e togjet e fjalëve të ndërmjetme (rum. *cuvintele și construcțiile incidente*):

Fjalët e togjet e fjalëve të ndërmjetme ndahen me presje kur hyjnë në përbërjen e një fjalie në fillim, në mes ose në fund të saj:

Dhe atëhere, **si për çudi**, më lindi dëshira të shkruaja edhe unë poezi. (2002: 48)

Dhe kishte ca arsye, **sipas mendjes time**, që të vepronte kështu. (2002: 48)

Nu avea motiv [,] **după părerea mea**[,] să acționeze așa.

[Nuk kishte arsye, për mendimin tim, të vepronte kështu.]

Subt influențele mahometane și venețiane și chiar[,] **poate** [,] sub clima ... nordică. (1995: 66) [Nën ndikimet islamike dhe veneciane dhe madje, ndoshta, nën ndikimin e klimës veriore ...]

7. Pjesëzat *po, jo* (rum. *da, nu* -adverbele de afirmație și de negație- ndajfoljet e pohimit dhe të mohimit), kur ndiqen nga një fjali që zbërthen përmbajtjen e tyre:

Po, fjalët në këto raste janë të tepërta. (2002: 48)

Da [,] fac mărturisire,

Că moartea pentru mine e dreaptă răsplătire. CARAGIALE O. VI 256 (1995: 66)

[Po, rrëfej, kjo vdekje për mua është një shpërblim i drejtë.]

Jo, ajo s'kishte ndërmend të ndahej nga kjo bukuri e rrallë e nga ky ajër i pastër. (2002: 48)

Nu [,] nu mai fac. CARAGIALE O. VI 30 (1995: 66) [Jo, nuk do ta përsëris më].

8. Në të dyjat gjuhët ndahen zakonisht me presje nga fjalia emrat në rasën thirrrore:

O Shqipërizë, gëzohu, se të erdhi prapë dita. (2002: 47)

Cucoane Matei [,] dumneata nu știi cine-i cuconița care a trecut. SADOVEANU, O. V 104 (1995: 66) [Zoti Matei, ju nuk e dini kush është zonjusha që sapo kaloi.]

Këndona, **bilbil**, këndona. (2002: 47)

Am trei copii [,] **Costică!** CARAGIALE, O. II 42 (1995: 67) [Kam tre fëmijë, Kostikë!]

9. Pashirrat ndahen me presje nga fjalia në të dyja gjuhët:

Oh, sa kohë kisha pa e dëgjuar atë këngë! (2002: 49)

Eh, po për mua e kenë therur atë ftujak! (2002: 49)

Ei [,] ce veste ne mai aduci de pe la târg? CREANGĂ, P. 44 (1995: 67)

[E pra, cfarë lajmesh na sjell nga panairi?]

Ha [,] ce este?...S-a întâmpat ceva? DELAVRANCEA, H.T. 103. (1995: 67)

[Hë, cfarë është? Cfarë ka ndodhur?]

Në rumanisht, nëse pashirrat ndiqen nga një emër në rasën thirrrore, atëherë, si në shqip, nuk vendoset presja midis pashirrmës dhe emrit, sepse konsiderohet se formojnë një njësi ku shqiptohen së bashku. Në fund të kësaj njësie mund të përdoret edhe pikë çuditje, në vend të presjes.

Ei Cătălin [,]acu-i acu

Ca să -ți încerci norocul. EMINESCU, O. I 174 (1995: 67)

[O Këtëlin, tani është momenti

Ta provosh fatin tënd.]

O Doamne! Da greu somn am dormit. ISPIRESCU, L. 119 (1995: 67)

[O Zot! Gjumë të thellë bëra/fjeta.]

Dëshirojmë të nxjerrim në pah se studime krahasuese mbi shqipen dhe rumanishten janë të shumta, por asnjëri prej tyre nuk ka nxjerrë në pah përdorimin pothuajse identik të shenjave të pikësimit në të dyja gjuhët. Pavarësisht karakterit konvencional të përdorimit të shenjave të pikësimit, në përgjithësi, kjo ngjashmëri do të ishte e pamundur nëse sistemet sintaksore të rumanishtes dhe të shqipes, qoftë në nivel fjalie, qoftë në nivel periudhe, nuk do të ishin kaq të afërta. Në studimet shqiptare me raportet midis shqipes e rumanishtes janë marrë E. Çabej, M. Domi, S. Floqi, E. Lafe, Sh. Demiraj, B. Bokshi. Çabej kishte theksuar: “Shqipja dhe rumanishtja kanë lidhje të ngushta në fushën e fonetikës, të morfologjisë, të leksikut, të formimit të tingujve, të sintaksës dhe frazeologjisë, të mënyrave të të thënit dhe të lokucioneve proverbiale, saqë – pa i harruar veçantitë – krijohet përshtypja se fjala është për **një frymë të vetme të gjuhës të manifestuar në dy forma**⁵ ... Besoj se këto raporte mund të vlerësohen drejt vetëm kur të vështrohen në kuadër më të gjerë të

5 Nënvizimi i autores.

relacioneve kulturore midis këtyre dy popujve.”⁶ Gjithashtu, M. Domi (1975) dhe S. Floqi këmbëngulën se strukturat sintaksore në shqip dhe rumanisht duhen parë edhe nga këndvështrimi më i gjerë i studimeve ballkanistike.

Në këtë artikull të shkurtër kemi analizuar përdorimin e presjes në shqip dhe rumanisht, në nivel fjalie, duke evidentuar rregullat dhe rastet kryesore gati identike në përdorimin e presjes nëpërmjet shembujve që kemi marrë nga dy punime me karakter normativ në të dyja gjuhët. Gjithashtu, kemi vënë re se parimi kryesor mbi të cilin mbështetet pikësimi në shqip dhe në rumanisht është ai sintaksor gërshetuar me parimin intonacionor. Për të ardhur në ndihmën e gjuhëtarëve apo studentëve që merren me studimin e gjuhës rumune, kemi dhënë edhe emërtimet të formave të pashtjelluara apo të funksioneve dhe marrëdhënieve sintaksore në rumanisht.

BIBLIOGRAFI

- Caragiale, I.L. *Opere. Vol.1. Nuvele și schițe*. Ed. “Cultura Națională”, București, 1930; vol. II. *Nuvele și schițe*. Ed. “Cultura Națională”, București, 1931; vol. VI. *Teatru*. Fundația pentru Literatură și Artă, București, 1936.
- Çabej, E., *Unele probleme ale istoriei limbii albaneze*, në “Studii și cercetări lingvistice”, 4, X, București, f. 531, 1959.
- Creangă, I., *Scrierile lui ...* Vol. I. Povești, Iași, 1890.
- Delavrancea, B. Ș. *Hagi-Tudose. Tipuri și moravuri*. Editura Librăriei Socec & Comp., București, 1903.
- Domi, M., *Considérations sur les traits communs ou paraleles de l'albanais avec les auteurs langues balkaniques et sur leur étude*, në “Studia albanica”, Tirana, 1, 1975, f. 81–91.
- Eminescu, M., *Opere. Ediție critică îngrijită de Perpessicius*. Vol. 1. Fundația pentru Literatură și Artă . București, 1939.
- Galaction, G., *Opere. Vol. I*. Editura pentru literatură și Artă a Societății Scriitorilor din R.P.R., București, 1949.
- Ispirescu, P., *Legende sau basmele românilor. Adunate din gura poporului*, București, 1892.
- Odobescu, A. I., *Scieri literare și istorice. Vol. I–III*. Editura Librăriei Socec & Comp., București, 1887.

⁶ Çabej 1959: 531.

- Rebreanu, L., *Ion. Roman. Vol. I–II*. Edit. “Cartea Românească”, București, 1939.
- Sadoveanu, M., *Opere. Vol. I–VIII*. Editura de Stat pentru Literatură și Artă, București, 1954–1959.
- Topciu, R. et all. *Dicționar albanez–român . Fjalor shqip–rumanisht*, Ed. Polirom, București, 2003.
- Îndreptar ortografic, ortoepic și de punctuație*. Ediția a V-a, Academia Română, Institutul de lingvistică “I. Iordan”. Editura Univers Enciclopedic, București, 1995.
- Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Shtëpia botuese Shkenca, Tiranë, 2002.